



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKAI"

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHË TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKAI" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2573	Nr. i faqj. Br. str / No. pg 1	
Data / Datum / Date: 11.09.2023		Pejë / Peë

Këshilli Drejtues

Datë: 11.09.2023

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit nr.04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Këshilli Drejtues i UHZ-së, në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet komisioni për Pagesat telefonike për stafin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Komisioni ka në përbërje këta anëtarë:
 - Prof. Ass. Dr. Vjosa Hajdari
 - Dr. Sc. Gentiana Gega
 - Prof. Asoc. Dr. Mersiha Kalac Kacamakovic
 - Diana Shala
 - Adnan Lataj
- III. Vendimi hyn ne fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së.

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu




Vendimi f'i dërgohet:

- Kryesueses së KD-së,
- Të lartpërmendurve,
- U.d. Sekretares së Përgjithshme,
- Kryesuesit të IT,
- Arkivit të UHZ-së.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 08.09.2023, Pejë

Këshilli Drejtues, në bazë të nenit 17 dhe 23, nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën për ndërtimin e kanalit të hapur atmosferik i parashtruar nga Rektori i UHZ-së Prof. Dr. Armand Krasniqi dhe jep këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET kërkesa nr. Ref. 2253, dt. 05.09.2023 për Inicimine Procedurave të Prokurimit për Kanal Atmosferik në Kampusin e UHZ-së.
- II. Këtij Vendimi i bashkëngjitet kërkesa e lartëcekur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UHZ-së, pasi shqyrtoj kërkesën me nr. Ref. 2253, dt. 05.09.2023 e parashtruar nga Rektori i UHZ-së Prof. Dr. Armand Krasniqi, me qëllim që duke e marr parasysh vizitat në teren nga ekspertet e fushave është parë e nevojshme që të ndërtohet një kanal i hapur atmosferik në mënyrë që të evidentohen këto ujëra dhe të mos shkaktohen përmbytje në këto hapësira, ku rrezikohet të përmbytet, bodrumi i fakultetit të Arteve i cili ka pas probleme të vazhdueshme me këto ujëra dhe po i njëjti problem shfaqet edhe me objektin e ri i cili do të ndërtohet për fakultetin e Biznesit dhe MTHM-së, si dhe mbrapa Rektoratit, ku uji i rrezikon të përmbytet trafon elektrike. Pra për realizimin e këtij aktiviteti nevojiten mjetet në vlerë prej 45,000.00 euro.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2023, vendosi i në dispozitiv të këtij vendim.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

Vendimi t'i dërgohet: Kryesuesit të KD-së; Rektorit të UHZ-së; Prorektorit për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë; U.D. Sekretarit të Përgjithshëm; Arkivit të UHZ – së;





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REKTORATI	
Nr. / Br. / No. <u>2253</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>1</u>
Data / Datum / Date: <u>05.09.2023</u> <small>Pejë / Pág</small>	

Data:	05.09.2023
Për:	Znj. Majlinda Belegu, Kryesuese e Këshillit Drejtues në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë
Nga:	z. Prof. Dr. Armand Krasniqi- Rektor/ Universiteti Haxhi Zeka në Pejë;
Lënda:	Kërkesë për aprovim për ndërtimin e kanalit të hapur atmosferik

E nderuara Kryesuese,

Duke marrë parasysh që hapësirat e jashtme rreth fakultetit të Arteve, fakultetit Juridik dhe në Rektorat kanë probleme të vazhdueshme me ujërat atmosferike (përmytje), sidomos kur ka reshje, menaxhmenti i UHZ-së në bashkëpunim me kompaninë "Hidro Drini" në Pejë, ka përgatitur projektin për ndërtimin e kanalit të hapur atmosferik.

Vlen të theksohet që në bazë të kërkesave të menaxhmentit të UHZ-së, projekti është përgatitur nga Kompania "Hidro Drini" në Pejë, si donacion (pa asnjë obligim financiar nga UHZ-ja).

Bazuar në vizitat në terren nga ekspertë të fushës është parë e nevojshme që të ndërtohet një kanal i hapur atmosferik në mënyre që të evitohen këto ujëra dhe të mos shkaktohen përmytje në këto hapësira, ku rrezikohet të përmytet, bodrumi i fakultetit të Arteve i cili ka pas probleme të vazhdueshme me këto ujëra dhe po i njëjti problem do shfaqet edhe në objektin e ri i cili do të ndërtohet për fakultetin të Biznesit dhe MTHM-së, si dhe mbrapa Rektoratit, ku uji rrezikon të përmyt trafon elektrike.

Për realizimin e këtij aktiviteti nevojiten mjete në vlerë prej: 45,000.00 €.

Andaj duke pasur parasysh që ky aktivitet nuk ka qenë i përfshirë në planifikimin financiar dhe planin e prokurimit për vitin fiskal 2023, ju drejtohem me këtë kërkesë:

- Për aprovimin e këtij aktiviteti për ndërtimin e kanalit të hapur atmosferik në hapësirat e jashtme të fakultetit të Arteve, Juridik dhe në Rektorat, ku hapet rruga për iniciimin e procedurës së prokurimit për angazhimin e një kompanie për kryerjen e punëve për ndërtimin!

Me respekt

Prof. Dr. Armand Krasniqi



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Këshilli Drejtues

Datë: 08.09.2023, Pejë

Këshilli Drejtues, në bazë të nenit 17 dhe 23, nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën për ndërtimin e kanalit të hapur atmosferik i parashtruar nga Rektori i UHZ-së Prof. Dr. Armand Krasniqi dhe jep këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET kërkesa nr. Ref. 2254, dt. 05.09.2023 Për Përgatitjen e Planit për Menaxhimin e Sigurisë (Sigurimi fizik) në Objektet e UHZ-së.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UHZ-së, pasi shqyrtoj kërkesën me nr. Ref. 2254, dt. 05.09.2023 e parashtruar nga Rektori i UHZ-së Prof. Dr. Armand Krasniqi, me qëllim që duke e marr parasysh se sigurimi i objekteve është çështje primare për ruajtjen e materialeve, paisjeve ruajtjen e të dhënave-kompjuterëve, kasafortave, arkivave si dhe mbrojtja e jetesës së njerëzve të cilët punojnë në objekte dhe masë shtesë sigurie në raste të ndonjë tentim, dhe kjo kontrata e cila është nënshkruar me datë 26.01.2021 dhe është në fuqi përfundon me datën 25.01.2024. Në mungesë të kuadrove/specialistëve të fushës duhet të angazhohet një kompani të specializuar për përgatitjen e Planit për menaxhimin e Sigurisë (Sigurimit fizik) në UHZ, pastaj në bazë të planit iniciohen procedura e prokurimit për angazhimin e një kompanie e cila do bëjë sigurimin fizik të objekteve të UHZ-së. Për realizimin e këtij aktiviteti nevojiten mjete në vlerë prej 1000 euro.

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2023, vendosi i në dispozitiv të këtij vendim.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesuesit të KD-së; Rektorit të UHZ-së; Prorektorit për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë; U.D. Sekretarit të Përgjithshëm; Arkivit të UHZ – së;



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No.	2507	Nr. i faq./ Br. str. / No. pg.	5
Data / Datum / Date:	08.09.2023	Peje	Pec

Këshilli Drejtues

Ref. Nr.

Pejë, 08.09.2022

Në bazë të nenit 17, paragrafit 3, nenit 166, paragrafit 1, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kreut VIII, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Ligji nr. 06/I -011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligji Nr. 08/L-196 Për Pagat Në Sektorin Publik, Udhëzimin Administrativ 15/2018 Për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Rregullores nr. 299 të dt. 08.02.2023 për Ngarkesën e Punës për Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët dhe Asistentët e Njësive Akadematike dhe Institutin për Shkencë dhe Arte të Universitetit "Haxhi Zeka", Këshilli Drejtues i UHZ -së në mbledhjen e mbajtur më dt. 07.09.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

Për përcaktimin dhe rregullimin e ngarkesës në punë dhe angazhimet në institucione/ndërmarrje publike apo private, vendore apo ndërkombëtare, brenda apo jashtë vendit të personelit akademik të Universitetit "Haxhi Zeka"

- Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt të punës në Universitetin "Haxhi Zeka", obligohet të përmbush detyrimet e tij/saj, të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës, Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Statutin, Rregulloret përkatëse të miratuara në komponentët qeverisëse e menaxhuese të universitetit dhe në kontratën e punës.
- Realizimi i detyrimeve nga personeli akademik, në kuptim të pikës I, përfshijnë:
 - Mësimdhënien sipas koeficientit të përcaktuar me rregullat në fuqi të UHZ-së;
 - Veprimtarinë kërkimore – shkencore dhe krijimtarinë artistike;
 - Organizimin dhe mbajtjen e provimeve;
 - Pjesëmarrjen dhe kontributin në forumet vendimmarrëse të njësisë akademike (Katedër, Departament, Këshillë, etj.);
 - Kryerjen e detyrave në kuadër të komisioneve, projekteve dhe detyrave të tjera të përcaktuara nga Dekani i njësisë akademike, Senati ose Rektori;
 - Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punimeve seminarike;
 - Mentorimin e studentëve të të gjitha niveleve të studimit, si dhe çdo detyrë tjetër që hyn në fushëveprimin e natyrshëm të funksionit mësimdhënës;
 - Mbështetjen e Universitetit/Njësisë akademike dhe programit në plotësimin dhe përmirësimin e standardeve të akreditimit, të caktuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA);
 - Detyra të tjera zyrtare të caktuara nga njësia akademike, të ndërlidhura me natyrën e angazhimit të personelit akademik sipas Statutit të UHZ-së, veçanërisht neneve 167 dhe 182, si dhe akteve tjera juridike relevante në fuqi.

3. Njësitë akademike, varësisht nga specifikat e programeve dhe aspekteve tjera, mund të vendosin rregulla të veçanta, përkthazi me përmbushjen e detyrave të personelit akademik, të përcaktuara me Statut dhe me këtë vendim.
4. Bazuar në standardet e akreditimit të miratuara nga AKA, personeli akademik është i detyruar që së paku dy (2) herë në javë të ketë qëndrim në zyrë ose në salla, sipas një orari të përcaktuar dhe transparent, duke evidentuar prezencën, me qëllim të zhvillimit të konsultimeve dhe këshillimeve për studentë, në lidhje me aktivitetet akademike dhe detyrat tjera të punës.
5. Përrjashtim nga pika 4 e këtij vendimi bëhet vetëm në rastet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, dhe veçanërisht në situata të pandemisë apo raste të ngjashme, shkaktuar si rezultat i fuqisë madhore.
6. Organizimi i punës për personelin akademik në studimet baçelor dhe master në njësitë akademike do të bëhet nga menaxhmenti i njësisë përkatëse, duke pasur parasysh detyrat e personelit akademik sipas këtij vendimi dhe Statutit të UHZ-së, si dhe aktet tjera juridike relevante në fuqi. Në organizimin e punës për personelin akademik, menaxhmenti i njësisë akademike do të veprojë në pajtim të plotë me legjislacionin e punës në fuqi në Republikën e Kosovës.
7. Personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, i ndalohej të themeloj marrëdhënie tjetër të rregullt pune në një institucion publik ose privat, vendor apo ndërkombëtar, brenda apo jashtë vendit.
8. Personeli akademik nuk mund të ketë marrëdhënie të rregullt pune me UHZ-në dhe të jetë i emëruar në një institucion publik ku natyra e emërimit të tij dhe ngarkueshmëria në kuptim të angazhimit do të përputhet me specifikat e marrëdhënies së rregullt të punës, pra qëndrim në zyrë brenda një orari të rregullt të punës i cili përputhet me orarin e rregullt të punës në UHZ, (ministër, këshilltar politik, kryeshf ekzekutiv, e të ngjashme, si dhe angazhime të tjera që ndikojnë në mospërmbushje të detyrave në UHZ).
9. Nuk përjashtohen mundësitë e angazhimit që i njeh legjislacioni i punës në Kosovë dhe angazhimet apo emërimet specifike në trupa/organe kolegjiale me funksion mbikëqyrës në institucione dhe agjenci publike të pavarura, me ngarkueshmëri siç përcaktohet në pikën 21, e që nuk cilësohet marrëdhënie e rregullt pune, ose përjashtohen nga marrëdhënia e rregullt e punës e njohur sipas ligjeve në vend dhe që në asnjë rrethanë nuk ndikojnë në përmbushjen e detyrave të punës në UHZ.
10. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, kanë të drejtë të angazhohen në cilësi të ekspertit profesional për nevoja të ekspertizave, konsulencave apo pjesëmarrjes në komisione ose grupe punuese në institucionet publike apo private, vendore ose ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi, me kusht që këto angazhime të mos ndikojnë në përmbushjen e detyrave të përcaktuara me kontratën e punës, Statutin e UHZ-së dhe këtë vendim. Angazhimet në cilësi të ekspertit profesional, me qëndrim në zyrë nuk lejohen për stafin që janë në marrëdhënie të rregullt të punës në UHZ. Monitorimin e kryerjes së detyrave të punës në UHZ ka për obligim ta përcjellë dhe raportoi Dekani i njësisë akademike, bazuar në formularin që dizajnohet nga Universiteti "Haxhi Zeka".
11. Angazhimi në marrëdhënie punësimiti të kufizuar në pajtim me nenin 166 të Statutit dhe këtë vendim, në një institucion publik të arsimit të lartë jashtë UHZ-së mund të bëhet pas njohfimit të Dekanit të njësisë akademike dhe të sigurohet leja nga Rektori i Universitetit.
12. Nuk lejohet angazhimi i personelit akademik në kolegje/institucione private të arsimit të lartë, përfshirë edhe deklarinë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, si staf akademik

- i institucionit privat të arsimit të lartë apo mbështetjen në çfarëdo forme të kolegjit/institucionit privat të arsimit të lartë, në procesin e akreditimit të programeve dhe atë institucional.
13. Marrëdhënia e jashtme e punës në një universitet publik apo institut shkencor ose institucion të ngjashëm publik, në kuptim të pikës 9 të këtij vendimi, nuk mund të kalojë më shumë se katër (4) orë angazhim në javë. Njoftimi për realizimin e angazhimit të personelit akademik, sipas pikës 9 të këtij vendimi duhet të përcaktoj ngarkesën e ligjërit për orë për javë dhe periudhën kohore (ditën dhe orën) kur do të realizohen orët e tilla.
 14. Aktiviteti i jashtëm mësimor/arsimor i personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune që realizohet sipas një marrëveshje ndërmjet UHZ-së dhe një institucioni tjetër publik të arsimit të lartë brenda apo jashtë vendit, nuk mund ta kalojë normën prej katër (4) orëve në javë, me përjashtim kur një e tillë specifikohet ekskluzivisht me marrëveshjet e tilla dhe ka të bëjë me ndonjë lëmi specifike që mund të shoqërohet edhe me mungesë të kuadrove.
 15. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ, është i detyruar të respektoj marrëdhënien e tij/saj të punës me UHZ-në, në të gjitha rastet ku ai/a jo ushtron punësim apo angazhim tjetër të përkufizuar sipas këtij vendimi, duke e paraqitur në mënyrë transparente titullin e tij/saj akademik dhe UHZ-në si punëdhënës primar.
 16. Personelit akademik të UHZ-së, i ndalohet të marr pjesë në aktivitete promovionale dhe/apo akademike në favor të një institucioni tjetër arsimor/kërkimor, në mënyrë të tillë që të dëmtoj karakterin konkurrues të UHZ-së në tregun e arsimit të lartë dhe hulumtimit shkencor.
 17. Ndërlidhur me pikën 15 të këtij vendimi si dhe pikat e tjera të këtij vendimi, Rektori, bazuar në propozimin e Dekanit të njësisë akademike, mund t'i ndalojë dhe kufizoj kontraktimin e punës jashtë UHZ-së, të punësuarit si personel akademik, nëse një gjë e tillë ndikon negativisht në reputacionin dhe/apo karakterin konkurrues të UHZ-së në tregun vendor dhe ndërkombëtar.
 18. Personeli akademik i cili përcaktohet për marrëdhënie të rregullt pune me pagë primare në një institucion tjetër jashtë UHZ-së, në UHZ do t'i pushojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet për sa kohë është në pozitën apo funksionin përkatës sipas legjislacionit të punës. Në rast se i njëjti/ta, angazhohet në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, kompensimi bëhet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrare, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit të përcaktuar sipas rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik.
 19. Personeli me thirrje akademike: Profesor asistent, Profesor i asocuar dhe Profesor i rregullt i cili/cila eventualisht mund të mban postin e rektorit në njërin prej universiteteve publike brenda Republikës së Kosovës, deri në përfundim të mandatit përkatës, nga UHZ-ja do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrare, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit të përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UHZ-së.
 20. Përcaktimi i ngarkesës për personelin e zgjedhur apo të emëruar në institucione publike sipas këtij vendimi rregullohet si vijon:
 - a. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune, me rastin e zgjedhjes në institucione publike (sipas Kushtetutës, Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe

- Lokale), i takon e drejta e pagesës (si pagë sekondare) në lartësi prej 20% të pagës bazë nga marrëdhënia e rregullt e punës në UHZ;
- b. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune, përfshirë edhe këshilltarët politikë apo si ekspertë, gjatë periudhës së ushtrimit të postit publik do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo me shumë se fondi i orëve të honorarit të përcaktuar sipas Rregullores për të ardhurat personale të personelit akademik;
 - c. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune, në mbështetje të institucioneve dhe agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës me ekspertizë akademike, e për të cilët kriter formal esencial është të qenurit pjesë e Universitetit (Këshilli i Shtetëror i Cilësisë, Këshilli Drejtues i njësive organizative ose ndërmarrjeve tregtare të UHZ -së, Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" e të ngjashme) apo përvoja akademike, si dhe ngarkueshmëria e tyre përputhet me definimin e përcaktuar në këtë vendim (emërimi në Bordet e ndërmarrjeve publike, Bordin e BQK-së, Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, Bordin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, bordet e institucioneve tjera të ngjashme publike dhe private), gëzon të drejtën e kompensimit shtesë për funksion përkatës, konform legjislacionit në fuqi për pagat në sektorin publik.
21. Dekanët e njësive akademike janë përgjegjës për përcjelljen dhe mbikëqyrjen e mbarëvajtjes së procesit mësimor (përfshirë: ardhje-vajtjen në punë, mbajtjen e mësimin, pjesëmarrjen në mbledhje të këshillit të fakultetit apo komisione tjera profesionale, kryerjen e detyrave që përcaktohen në kuadër të komisioneve dhe projekteve ku caktohen, sjelljen me studentë dhe personelin tjetër, etj.), si dhe përmbushjen e detyrimeve tjera të personelit akademik sipas këtij vendimi dhe raportimin me kohë të gjitha rasteve kur veprohet në kundërshtim me këtë vendim, si dhe për marrjen e masave konkrete, bazuar në Statut dhe aktet e brendshme në fuqi të Universitetit.
 22. Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, shefat e qendrave dhe koordinatorët e zyrave në parim nuk mund të kenë angazhim tjetër shtesë jashtë UHZ-së për mësimdhënie me kontratë sekondare të punës në Universitetet tjera brenda apo jashtë vendit, brenda orarit ditor të punës, për shkak të përgjegjësisë menaxheriale që kanë.
 23. Rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, shefat e qendrave dhe koordinatorët, kanë të drejtë që të kërkojnë leje dhe të angazhohen në mësimdhënie në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, jashtë UHZ-së, angazhimi i tyre bëhet sipas pikës 11 të këtij vendimi, përjashtimisht Rektorit, kërkesa e tij/saj miratohet ose jo nga Këshilli Drejtues i Universitetit, dhe për këtë njoftohet edhe Senati.
 24. Në çdo rast, kërkesa e parashtruar për angazhim, duhet t'i përmbahet dispozitave të këtij vendimi, si dhe e njëjta nuk mund të realizohet brenda orarit ditor të punës.
 25. Dekani është i obliguar që një raport përmbledhës t'ia dërgoi për njoftim Rektorit për angazhimet e personelit akademik të njësisë akademike që ai/ajo e udhëheq, në institucionet e arsimit publikë të lartë, si dhe angazhimet e tjera, sipas dispozitave të këtij vendimi, bazuar në të dhënat e deklaruara sipas formularëve përkatës. Raporti dërgohet të paktën një (1) herë brenda vitit akademik.
 26. Personeli akademik i cili nuk e respekton afatin e përcaktuar në pikën 17, të këtij vendimi, do të njoftohet për iniciimin e procedurës disiplinore dhe mundësinë e ndërprerjes së kontratës së punës.

27. Këshilli Drejtues i UHZ-së mban të drejtën ekskluzive për përditësimin dhe interpretimin e këtij vendimi sa herë që e konsideron të nevojshme apo edhe sipas kërkesave ligjore. Ndërlidhur me këtë, Këshilli do t'i shqyrtoj kërkesat/ankesat eventuale mbi zbatimin jo efikas dhe jo të drejtë të këtij vendimi nga ana e subjekteve përgjegjëse për zbatimin e tij.
28. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 035, datë 11.01.2021, i Këshillit Drejtues të UHZ-së.
29. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit

Arsyetim

Bazuar në kompetencat statutare për sigurimin dhe mbarëvajtjen e përgjithshme të punës në Universitetin "Haxhi Zeka", në veçanti çështjeve që kanë të bëjnë me sigurimin dhe rritjen e cilësisë, fuqizimit të kapaciteteve të UHZ-së, qartësimin dhe rregullimin marrëdhënies së punës, gjithashtu duke i pasur parasysh rrethanat dhe faktorët aktual të cilat po e karakterizojnë dinamikën e zhvillimit të arsimit në vend, Këshilli Drejtues e konsideron të domosdoshëm nxjerrjen e këtij akti në mënyrë që të kontribuojë që UHZ – ja, të zhvillojë veprimtarinë e vet për realizimin e të gjitha komponentëve të misionit që ka si një institucion e arsimit të lartë cilësor, konkurrent, duke përfshirë qartë ngritjen e përgjithshme të performances së punës së UHZ-së. Në funksion të kësaj, rishikimi dhe përditësimi i Vendimit me nr. prot. 035, datë 11.01.2021, të Këshillit Drejtues, ka qenë i nevojshëm për shkak të moszbatimit efikas, të drejtë dhe të përgjithësuar dhe për shkak të nevojës së mbulimit të zbrazëtirave të krijuara në ofrimin e ekspertizës së stafit akademik në interes të shtetit, në të gjitha fushat.

Në mënyrë të posaçme duhet theksuar se përmbajtja e pikave të dispozitivit që ndërlidhen me ngarkesën në punë është e bazuar në Rregulloren nr. 299 të dt. 08.02.2023 për Ngarkesën e Punës për Mësimdhënësit, Bashkëpunëtorët dhe Asistentët e Njësive Akademike dhe Institutin për Shkencë dhe Arte të Universitetit "Haxhi Zeka". Me qëllim të ngritjes së efikasitetit, përgjegjësisë dhe vijueshmërisë në punë, si dhe përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie, në kuadër të zbatimit të Ligjit të Punës, Statutit të UHZ-së dhe akteve tjera juridike përkatëse në fuqi, Këshilli Drejtues i UHZ-se lidhur me caktimin e parimeve të punësimit, të drejtave, detyrimeve dhe kushteve tjera për personel, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

T'u dërgohet:

1. Arkivit të UHZ-së;
2. Rektorit;
3. Prorektorëve;
4. Sekretarit të përgjithshëm;
5. Dekanëve të njësive akademike;
6. Sekretareve të njësive akademike;
7. Zyrës për buxhet dhe financa

Kryesuesja e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Dr.sc. Majlinda Belegu





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Këshilli Drejtues

Datë: 11.09.2023, Pejë

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, dhe kërkesës me nr. Ref. 2251 e dt. 05.09.2023, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Ndahen mjetet buxhetore për përfaqësuesit e jashtëm të KQZ-sës dhe Anëtarëve (studentëve) në KZF, për organizimin e zgjedhjeve studentore në UHZ.
- II. Ndarja e mjeteve bëhet si në vijim:
 - Abdurrahim Haxhisefa – Përfaqësues nga KQZ-ja e Republikës së Kosovës në cilësi të monitoruesit, 309 euro.
 - Kreshnik Kabashi – Përfaqësues i organizatës studentore (USSH), 309 euro.
 - Bleona Mustafa – Anëtare në KZF në fakultetin e Biznesit (studentë, 309 euro.
 - Altin Mehmetaj - Anëtar në KZF në fakultetin e Juridik (studentë), 309 euro.
 - Fatjan Demhasaj – Anëtar në KZF në fakultetin e Agrobiznes (studentë), 309 euro.
 - Atdhe Krasniqi - Anëtar në KZF në fakultetin e MTHM (studentë), 309 euro.
 - Altin Osmanaj – Anëtar në KZF në fakultetin e Arteve (studentë), 309 euro.
- III. Ndarja e mjeteve për organizatën Studentore pjesëmarrëse, është 1000 euro.
- IV. Shuma e mjeteve totale e lejuar është **3,163.00 euro**.
- V. Obligohet Zyra për financa të ndaj shumën e lejuar konform këtij vendimi.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë, Zyrës për Financa, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Br. / No. 2570	Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1	
Data / Datum / Data: 11/09/2023		Pejë - Peç

Këshilli Drejtues

Datë: 11.09.2023, Pejë

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohet Vendimi me nr. Ref. 1456, datë 06.06.2023 i Këshillit Drejtues të UHZ-së, për ndarjen e mjeteve buxhetore për KQZ, KZF, staf mbështetës të KQZ/KZF, për organizimin e zgjedhjeve të studentëve 2023 të UHZ-së.
- II. Vendimi i shfuqizuar është për stafin e brendshëm të UHZ-së.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, ka marrë vendim për shfuqizimin e vendimit nr. Ref. 1456, të datës 06.06.2023, me arsyetimin që ky vendimi të cilën e kem nxjerr për ndarjen buxhetore për KQZ, KZF, staf mbështetës të KQZ/KZF-së për organizimin e zgjedhjeve studentore 2023 të UHZ-së, jemi njoftuar nga Prorektorja Prof. Ass. Dr. Vjosa Hajdari për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë dhe Zyra për buxhet dhe financa që gjatë takimit që është mbajtur në MPB në mes Universitetit, DMZP-së, departamenti ligjor dhe divizionit të pagesave/ Thesar kanë ngritur çështjen lidhur me vendimin e ndarjeve të mjeteve buxhetore për KQZ, dhe janë njoftuar që stafi i brendshëm nuk mund të kompensohet për pjesëmarrje në komisione, duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik në nenin 38, kompensimet për funksion shtesë, Rregullores Nr. 10/2023, pra stafi i brendshëm nuk mund të paguhet, ndërsa sa i përket stafit të jashtëm mund të kompensohen sipas akteve ose sipas vendimit që nxjerr KD-ja. Andaj, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu



Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë, Zyrës për Financa, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Këshilli Drejtues

Data: 11.09.2023, Pejë

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, dhe kërkesës me nr. Ref. 2102 e dt. 15.08.2023, për mbështetje financiare për udhëtim zyrtar në kuadër të Fakultetit/Universitetit, e parashtruar nga Dekani i Fakultetit të Arteve, Prof. Asoc. Ma, Hysen Nimani, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, mori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa me nr. Ref. 2102 e dt. 15.08.2023, e parashtruar nga Dekani i Fakultetit të Arteve, Prof. Asoc. Ma, Hysen Nimani, për mbështetje financiare për udhëtim zyrtar në kuadër të Fakultetit/Universitetit në Paralia/Greqi në festivalin XI ndërkombëtarë të korit "MUSIC & SEA".
- II. Shërbimi financiar e procedon shumën në vlerë prej **4, 780.00 euro**.
- III. Shërbimi financiar e procedon shumën konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2023, shqyrtoj kërkesën nr. Ref. 2102 e dt. 15.08.2023, për mbështetje financiare për udhëtim zyrtar në kuadër të Fakultetit/Universitetit, e parashtruar nga Dekani i Fakultetit të Arteve, Prof. Asoc. Ma, Hysen Nimani, ku sipas kësaj kërkesë pjesëmarrja e studentëve në festival XI ndërkombëtarë të korit "MUSIC & SEA" që do organizohet në Paralia/Greqi i cili do të mbahet me 17-23 shtator 2023, ka rendësi shumë të madhe në promovimin e UHZ-së, ku de të ketë promovime kulturore dhe është një tregues shumë domethënës ku aktiviteti akademik shkrihet me jetën e koncertale në nivel profesional. Fakulteti i Arteve ka 5 vite që është pjesë e organizimeve me të rëndësishëm kulturor vendor dhe ndërkombëtare, më interpretime nga studentët dhe profesorët e fakultetit të Arteve. Nga kori i fakultetit do marrin pjesë 30 studentë dhe 4 staf të fakultetit. Shuma financiare për shpenzime akomodimi (fjetje dhe ushqim), janë në vlerë prej 4,050.00 euro, pjesëmarrja në koncert është 200.00 euro, provizion për pagesë të studentëve është 30.00 euro dhe shpenzimet të tjera 500.00 euro, gjithsej shpenzimet të krijuara për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare janë 4,780.00 euro. Shpenzimet e stafit të brendshëm kompensohen sipas Rregullores nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe vendimit nr.30/2018. Duke u bazuar në rëndësinë e promovimit të Universitetit, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

Majlinda Belegu

Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë, Zyrës për Financa, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të UHZ-së.





UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr./Br./No. 2572	Nr./faq./Dr. nr./No. pg 1	
Data / Datum / Date: 11 09 2023		

Këshilli Drejtues

Datë: 11.09.2023, Pejë

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, dhe kërkesës me nr. Ref. 2251 e dt. 05.09.2023, për mbështetje financiare, e parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 07.09.2023, mori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa me nr. Ref. 2251 e dt. 05.09.2023, e parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, për mbështetje financiare për organizimin e ditës së boshnjakëve.
- II. Shërbimi financiar e procedon shumë në vlerë prej **2,595.00 euro**.
- III. Shërbimi financiar e procedon shumë konform legjislacionit në fuqi.
- IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me datë 07.09.2023, shqyrtoj kërkesën nr. Ref. 2251 e dt. 05.09.2023, për mbështetje financiare për organizimin e ditës së boshnjakëve, e parashtruar nga Prof. Ass. Dr. Suada Ajdarpasic, ku sipas kësaj kërkesë Instituti i Shkencës dhe Artit të UHZ-së ka planifikuar që me 28 shtator në ditën e boshnjakëve është planifikuar të organizohet një tryezë e rrumbullakët për boshnjakët, ku pjesëmarrës do jenë eminentë të Kosovës dhe rajonet e Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Sanxhaku. Tema e tryezës do të jetë "Roli i arsimit në krijimin e identitetit kulturor dhe gjuhësor të boshnjakëve të Kosovës-sfidat dhe perspektivat". Në këtë organizim do të marrin pjesë 25 pjesëmarrës, 10 prej të cilëve do të jenë folës kryesorë, ndërsa pjesa tjetër do të jetë menaxhment i universitetit personal akademik nga Departamenti i Gjuhës Boshnjake. Për organizimin e këtij aktivitetit nevojiten mjete financiare për Akomodim (8 persona, 2 netë, 70 euro, $16 \cdot 70 = 1120$ euro), Transport (8 persona 100 euro për karburant $8 \cdot 50 \text{ euro} = 800$ euro), Dreka, (25 persona 20 euro, $25 \cdot 20 \text{ euro} = 500$ euro), Pije (25 persona, 2 ujë, 1 kafe, $25 \cdot 3 = 75$ euro), Baner (1 baner 100 euro), gjithsej shpenzimet e krijuar për këtë organizime janë në vlerë prej 2,595.00 euro. Poashtu z. Ferid Muhic nuk do e shfrytëzoj akomodimin, ndërsa i lejohet shpenzimet e transporti në vlerë 250 euro të cilat i transferohet në llogarinë e tij. Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së

Prof. Ass. Dr. Majlinda Belegu

Vendimi t'i dërgohet: Kryesueses së KD-së, Palës, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë, Zyrës për Financa, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivës.

